

GAZETARIA NË KOHË KRIZE

KONFERENCË E OSBE-SË PËR MEDIAN
NË EVROPËN JUGLINDORE

11-12 TETOR 2021, HOTEL ROGNER, TIRANË, SHQIPËRI

PROGRAMI

Dita 1: E Hënë, 11 tetor 2021

NISJA	FUNDI	NGJARJA
9:00	9:30	<ul style="list-style-type: none">• Regjistrimi dhe kafeja e mirëseardhjes për pjesëmarrësit në sallë• Lidhje me ZOOM për pjesëmarrësit në rrjet (do të dërgohet linku)
9:30	9:35	Fjala e mirëseardhjes <ul style="list-style-type: none">• Teresa Ribeiro, OSCE Representative on Freedom of the Media
9:35	9:55	Fjalët hapëse <ul style="list-style-type: none">• Sh.T.Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë• Sh.T.Z. Vincenzo Del Monaco, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri
10:00	10:15	Fjalimi kryesor <ul style="list-style-type: none">• Julie Posetti, Drejtoresha e Përgjithshme e Kërkimit, Qendra Ndërkombëtare për Gazetarët

10:15	11:45	<p>Seanca I: Dezinformimi dhe Gazetaria Hulamtuese Cilësore</p> <p>Me përhapjen gjithnjë e në rritje të dezinformimit në Evropën Juglindore, gazetaria hulamtuese cilësore në këtë rajon haset me sfida të mëdha. Dezinformimi minon besimin e publikut tek gazetaria profesioniste dhe cilësore, si dhe tek roli i saj në shoqëritë demokratike – çka amplifikohet më tej në kohë krizash, siç është edhe pandemia aktuale e COVID-19ës. Besimi i publikut tek mediat informuese bazohet tek informacionet e sakta, të paanshme dhe me fakte të kontrolluara. Angazhimi ndaj parimeve themelore të gazetarisë, si paanësia dhe raportimi me fakte, është shumë i rëndësishëm për të ndërtuar besimin tek media dhe shërben për të ndrequr dezinformimin.</p> <p>Paneli do të ofrojë një tablo më të mirë të dezinformimit dhe të shkaqeve që e krijojnë atë, të rreziqeve që kanosen prej tij dhe të rolit që mund të luajë gazetaria për t’iu kundërvënë dezinformimit. Gjithashtu, pjesëtarët e panelit do të diskutojnë nismat dhe praktikat e rajonit për t’iu qasur këtij rreziku që kërcënon peizazhin pluralist të medias, si asaj tradicionale edhe asaj në rrjet, dhe do të propozojnë zgjidhje për përmirësimin e mëtejshëm të medias.</p> <p>Moderator: Andrey Rikhter, Këshilltar i Lartë, Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias</p> <p>Pjesëtarët e panelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Milka Tadić Mijović, Kryetare, Qendra për Raportimin Hulamtues, Mali i Zi • Sarah Clarke, Kryetare për Evropën dhe Azinë Qendrore, ARTICLE 19 (NENI 19) • Elisa Spiropali, Ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Shqipëri • Bardhyl Jashari, Themelues dhe Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni Metamorphosis (Metamorfoza), Maqedonia e Veriut • Kristina Voko, Drejtoreshë Ekzekutive, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulamtuese/BIRN, Shqipëri • Milovan Nikolić, Ndhmës Redaktor, FakeNews Tragač <p>Pyetje & Përgjigje</p>
11:45	12:15	<p>Pushim kafeje</p>
12:15	13:45	<p>Seanca II: Siguria dhe Kushtet e Punës së Gazetarëve</p> <p>Siguria e gazetarëve – ky parakusht themelor për lirinë e medias dhe për realizimin e të drejtës universale për liri të shprehjes – vijon të jetë një prej shqetësimeve më të mëdha në rajonin e Evropës Juglindore. Sulmet fizike dhe verbale, kërcënimet në rrjet dhe</p>

		<p>frikësimi i gazetarëve, veçanërisht gjatë raportimeve të grumbullimeve publike kur sulmohen gazetaret gra, krijojnë klimë frike dhe censure dhe nxisin drejtpërdrejtë rrudhjen e lirisë së medias. Pengesat financiare, mungesa e sigurisë së punësimit dhe e kujdesit shoqëror i vështirësojnë më tej kushtet e gazetarëve në rajon. Pandemia aktuale e COVID-19ës ka përkeqësuar kushtet e përgjithshme të punës, veçanërisht për gazetarët në profesion të lirë dhe për organet mediatike të pavarura.</p> <p>Seanca e dytë do të ofrojë njohuri më të thelluara për tendencat në rajon dhe për sfidat aktuale në lidhje me sigurinë dhe me kushtet e punës së gazetarëve, me dëshmi personale nga dy gazetarë të rajonit. Këtu do të theksohen praktikat më të mira dhe përpjekjet për të trajtuar situatën e rënduar të gazetarëve dhe pengesat që ata hasin përgjatë zhvillimit të veprimtarive gazetareske dhe zbatimit të të drejtës së shprehjes, si në rrjet edhe jo në rrjet, në kontekstin e krizës aktuale shëndetësore.</p> <p>Moderator: Ricardo Gutierrez, Sekretar i Përgjithshëm, Federata Evropiane e Gazetarëve</p> <p>Pjesëtarët e panelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lejla Turčilo, Profesoreshë, Fakulteti i Shkencave Politike, Universiteti i Sarajevës • Mihailo Jovović, Kryeredaktor i gazetës “Vijesti” dhe Kryetar i Komisionit për Monitorimin e Investigimeve të Sulmeve ndaj Gazetarëve • Veran Matić, Themelues dhe Kryetar, Shoqata e Medias Elektronike të Pavarur dhe Anëtar i Grupit të Përhershëm të Punës për Sigurinë e Gazetarëve, Serbi • Dragan Sekulovski, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë • Blerjana Bino, Bashkëthemeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra e Shkencës dhe Novatorizmit për Zhvillim, Shqipëri <p>Dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dragan Bursać, Gazetar i Pavarur • Jelena Zorić, Gazetar, Insajder TV <p>Pyetje & Përgjigje</p>
13:45	15:00	Dreka
15:15	16:45	Aktivitet Anësor: Trajtimi i Përpjekjeve për të Heshtur Gazetaret Gra në Internet (shih ftesën dhe programin)

19:00	20:30	Pritje dhe Darkë në kuadër të Konferencës Vendi: Hotel Rogner
-------	-------	---

Dita 2: E Martë, 12 tetor 2021

NISJA	FUNDI	NGJARJA
8:45	9:15	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi dhe kafeja e mirëseardhjes për pjesëmarrësit në sallë • Lidhje me ZOOM për pjesëmarrësit në rrjet (do të dërgohet linku)
9:15	10:45	<p>Seanca III: Gazetaret dhe Drejtueset e Mediave</p> <p>Përfshirja dhe përfaqësimi i barabartë i grave në sektorin e medias është i rëndësishëm jo vetëm për të siguruar të drejtën e grave për liri të shprehjes dhe aftësinë e tyre për të ofruar shërbim publik, por edhe për të përkrahur lirin dhe pluralizmin në media, elemente thelbësore këto për mjedis mediatik të gjallë në shoqëri demokratike. Duke qenë se mediat kanë rol transformues për formësimin e pikëpamjeve rreth çështjeve gjinore në shoqëri, ato mund të ndihmojnë përkrahjen e të drejtave themelore në shoqëri, duke përfshirë të drejtat e grave.</p> <p>Kjo seancë me panel ka për qëllim të shërbejë si platformë për diskutimin e sfidave profesionale të kohës dhe rreziqet e posaçme për shkak të gjinisë me të cilat përballen gazetaret në rajonin e Evropës Juglindore. Pjesëtarët e panelit do të shkëmbejnë përvoja, përfshirë këtu edhe dëshmi personale nga dy gazetarë të rajonit, dhe do të shkëmbejnë praktikën pozitive dhe nismat për përkrahjen e barazisë gjinore në sektorin e medias. Gjithashtu, pjesëtarët e panelit do të bëjnë rekomandime për qasjen ndaj hendeqeve ekzistuese, me qëllim të kemi redaksi të ekuilibruara nga pikëpamja gjinore dhe të përmirësojmë gjendjen e gazetarëve në rajon.</p> <p>Moderatore: Clarisse Pásztor, Zëvendëskryetare e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri</p> <p>Pjesëtarët e panelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Borka Rudić, Sekretare e Përgjithshme, Shoqata e Gazetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës • Rozeta Tase, Kryeredaktore, Albanian Daily News • Kristina Ozimec, Kryetare, Platforma për Gazetari Huluntuëse dhe Analizë,

		<p>Maqedonia e Veriut</p> <ul style="list-style-type: none"> • Alice Taylor, Redaktore e Exit.al dhe anetare e Koalicionit të Grave në Gazetari • Snežana Milošević, Sekretare e Përgjithshme, Shoqata e Mediave Vendore të Pavarura “Local Press”, Serbi • Brikenda Rexhepi, Zëvendëskryeredaktore, Koha Ditore/KTV/Koha.net <p>Dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leila Bičakčić, Drejtoreshë, Qendra për Raportimin Hulumtues, Bosnje dhe Hercegovina • Tinka Djuranović, Drejtoreshë Ekzekutive, Portal Analitika <p>Pyetje & Përgjigje</p>
10:45	12:00	<p>Seanca IV: Paditë Strategjike, kërcënim në rritje ndaj medias së pavarur</p> <p>Gazetarët dhe organet mediatike në Evropën Juglindore dhe më gjerë gjithnjë e më shumë po sulmohen ligjërisht me anë të të ashtuquajturave Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike. Paditë Strategjike kanë për qëllim të heshtin dhe të frikësojnë punonjësit e mediave që raportojnë rreth çështjeve me interes publik, duke i mbytur mediat me procese ligjore të gjata dhe të kushtueshme. Ky fenomen rrezikon të rruhdhë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe medias së lirë dhe të dobësojë shtetin e së drejtës pasi këto lloj padishë jo vetëm mbysin zërat kritikë, por shkaktojnë presion të madh financiar dhe psikologjik tek gazetarët dhe tek organet mediatike.</p> <p>Ky panel do të analizojë praktikën gjithnjë në rritje të sulmeve ligjore ndaj gazetarëve dhe organeve mediatike në rajon. Në këtë kontekst, pjesëtarët e panelit do të shqyrtojnë mjedisin ligjor të rajonit dhe ndikimet e tij tek fjala e lirë dhe tek liria e medias dhe do të shkëmbejnë ide rreth veprimeve që duhen ndërmarrë për të mposhtur praktikën e dëmshme të Padive Strategjike.</p> <p>Moderatore: Paola Rosà, Bashkërenduese e Qendrës Burimore për Lirinë e Medias, OBC Transeuropa</p> <p>Pjesëtarët e panelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Flutura Kusari, Këshilltare Ligjore, Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias • Veljko Milić, Jurist dhe Anëtar Bordi i Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës, Serbi • Klodiana Kapo, Drejtoreshë Ekzekutive, Faktoje.al • Dalibor Tomović, Jurist, Mali i Zi <p>Pyetje & Përgjigje</p>

12:00	12:30	Pushim kafeje
12:30	13:30	<p>Seanca V: E ardhmja e gazetarisë: Pikëpamjet e reja për median</p> <p>Pjesëmarrja e gazetarëve të rinj në sferën publike është e rëndësishme jo vetëm për të garantuar pluralizëm të medias, por edhe për të ndërtuar shoqëri demokratike, gjithëpërfshirëse dhe të forta, si dhe për të përfutur ide dhe zgjidhje të reja.</p> <p>Seanca e fundit do t’u japë mundësi gazetarëve të rinj të rajonit të Evropës Juglindore të prezantojnë kornizën e dokumentit për shprehjen e qëndrimit për rininë dhe median, dokument ky që përshkruan pikëpamjet dhe propozimet e tyre për përmirësimin e gjendjes së gazetarëve të rajonit. Dokumenti për shprehjen e qëndrimit do të zhvillohet këtë vit në Kampin Rinor “Vëmendja tek të Rinjtë dhe tek Media” si pjesë e “Shtigjeve Rinore: Përkrahja e Vlerave të OSBE-së në Ballkanin Perëndimor”; program pararendës shkëmbimi rinor që organizohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe që përqendrohet tek përkrahja e paqes dhe stabilitetit në rajon.</p> <p>Moderatore: Farah Karimi, Përfaqësuesi Pocacëm për Angazhimin e Rinisë, Asambleja Parlamentare e OSBE-së</p> <p>Pjesëtarët e panelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Iris Luarasi, Eksperte e Fushës së Medias • Gazetar – Pjesëmarrës i Shtigjeve Rinore • Gazetar – Pjesëmarrës i Shtigjeve Rinore • Armela Krasniqi, Kryetare, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Shqipëri • Anastasia Fusco, Këshilltare për të Rinjtë dhe Sigurinë, Sekretariati i OSBE-së <p>Pyetje & Përgjigje</p>
13:30	13:45	<p>Fjala përmbyllëse Teresa Ribeiro, Përfaqësuesja e OSBE-së për Lirinë e Medias</p>
13:45	15:00	Dreka